

VENDIM
Nr. 785, datë 14.11.2012

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SISTEMIMI I SHTRATIT TË LANËS
DHE NDËRTIMI I RRUGËVE PARALEL SAJ (SEGMENTI NGA MATERNITETI I RI NË
GJATËSINË 400 M NË DREJTIM TË KUNDËRT TË RRJEDHËS SË LANËS) NË BASHKINË
E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi i shtratit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralel saj (segmenti nga Materniteti i Ri në gjatësinë 400 m në drejtim të kundërt të rrjedhës së Lanës) në Bashkinë e Tiranës.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 2 598 (dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) m² truall dhe 48 (dyzet e tetë) m² objekt, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 57 826 118 (pesëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga buxheti i Bashkisë së Tiranës.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Tiranës.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia e Tiranës, për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 2 598 (dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë) m² truall dhe 48 (dyzet e tetë) m² objekt, shpronësuar në favor të Bashkisë së Tiranës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha